



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1346 , date 23. 07. 2010

Për

“Shqyrtimin e ankimit administrativ te Eagle Mobile sh.a. per ndryshim te Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.07. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Ankimi administrativ i sipermarresit Eagle Mobile sh.a. me dt.28.04.2010 per ndryshim te Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”.

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja ç) e neni 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);

2. pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (KprA)

3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

4. “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, te Keshillit Drejtues te AKEP (**Rregullorja**).

5. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1400, date 14.06.2010.

6. Vendim i KD të AKEP-it, nr. 1212, datë 31. 03. 2010 “Per percaktimin e sipermarresit Eagle Mobile Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, te perbere nga:

- Ankimi Administrativ i sipermarresit Eagle Mobile sh.a, paraqitur me shkrese nr.1423/1, date 28.04.2010 me objekt per ndryshim te Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” (**Ankimi Administrativ**);
 - Vendim i KD te AKEP, nr.1212 date 31.03.2010 “Per percaktimin e sipermarresit Eagle Mobile Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”;
 - Projektvendim i KD te AKEP “Per shqyrtimin e ankimit administrativ te Eagle Mobile sh.a. per ndryshim te Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”(**Projektvendimi**);
 - Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);
- si dhe,
- diskutimeve në mbledhje mbi çështjen,
 - bazes ligjore te sipercituar

V Ë R E N :

1. Sipermarresi Eagle Mobile sh.a me shkresen nr.1423/1 prot, date 28.04.2010 brenda afatit ligjor te percaktuar ne nenin 140 te ligj nr.8485, ka bere ankim administrativ me objekt “ Per

ndryshim te Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese per Vendimin e KD nr.1212 ,date 31.03.2010””.

2. Ankimi administrativ i Vendimit nr.1212 date 31.03.2010 “Per percaktimin e sipermarresit Eagle Mobile Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese” ka objekt kundershimitin e plote te vendimit dhe ben detajimin si ne vijim:

a) Eagle Mobile te mos percaktohet sipermarres me FNT ne tregun me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e tij;

b) Ne rast se nuk merret germa a) ne konsiderate nga AKEP, operatori Mobile 4 AL te percaktohet gjithashtu sipermarres me FNT ne tregun me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e tij ashtu si sipermarresit e tjere;

c) Ne rast se germa a) nuk merret ne konsiderate nga AKEP, detyrimet e Eagle Mobile te percaktohen qartesisht vetem ne lidhje me tregun me shumice te terminimit te thirrjeve ne rrjetin e tij duke hequr ose ndryshuar ne nenet 4 dhe 5 te Vendimit 1212 date 31.03.2010, perfshire pikat ‘b-ë’ te pikes 4.3, pasi jane detyrime qe i takojne sipermarresit ne tregun me shumice te akses dhe origjinimit te thirrjeve;

ç) Tarifa maksimale e terminimit te thirrjeve ne rrjetin e Eagle Mobile e percaktuar ne nenin 4.4.2 te Vendimit 1212 date 31.03.2010 te ndryshohet duke respektuar nje asimetri ndaj tarifave te VFAL dhe AMC te barabarte me 23%;

3. Ankimi administrativ i Eagle Mobile sh.a, i paraqitur ne AKEP me shkresen nr.1423/1 prot. date 28.04.2010, per ndryshim te Aktit Administrativ, Vendim nr.1212, date 31.03.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, pezullon efektet e tij, nga data e depozitimit te ankimit ne AKEP deri ne marrjen e nje vendimi perfundimtar te AKEP mbi ankimin administrativ.

4. AKEP, duke iu referuar ankimit te Eagle Mobile, Vendimit te KD nr. 1212, date 31.03.2010, dhe arsytimit te dhene ne dokumentin “Analize e Tregut te Telefonise Celulare: Tregu me pakice i sherbimeve celulare dhe tregjet me shumice te terminimit dhe origjinimit ne rrjete celulare”, veren se:

- percaktimi i Eagle Mobile si sipermarres me FNT per terminimin e thirrjeve ne rrjetin Eagle Mobile eshte ne perputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator dhe me kushtet aktuale te tregut ne Shqiperi si dhe me praktikaten me te mira ne vendet e BE ;
- mospercaktimi i Mobile 4 Al si sipermarres me FNT per terminimin e thirrjeve ne rrjetin Mobile 4 Al eshte ne perputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator ne Shqiperi, me kushtet aktuale te tregut, praktiken e ndjekur me Eagle Mobile (mospercaktimi i

Eagle Mobile si operator me FNT ne Analize 2006 dhe Analize 2007), si dhe me praktikat me te mira ne vendet e BE;

- pika 3 e VKD nr. 1212, date 31.03.2010, percakton qartesisht se detyrimet e Eagle Mobile, te detajuara me tej ne pikat e tjera te vendimit, jane vetem per terminimin e thirrjeve ne rrjetin Eagle Mobile;
- detyrimet e pikes 4.3, ne germat 'b', 'd', 'dh', 'e' dhe 'ë', te VKD nr. 1212, date 31.03.2010, aktualisht perbejne detyrime qe nuk lidhen me sherbimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin Eagle Mobile;
- perfshirja ne piken 5 te te VKD nr. 1212, date 31.03.2010, te frazes '*dhe akses dhe origjinimit te thirrjeve*' dhe ne nje paragraf te farzes te sipermarresit AMC Sh.a., perbejne lapsus-e;
- reduktimi i nivelit te asimetrise midis tarifes se terminimit ne Eagle Mobile dhe tarifes se terminimit ne rrjetet AMC dhe Vodafone Albania, nga 27% ne 16% eshte e justifikuar nga ndryshimet ne treg dhe ne perputhje me pervojen ne vendet e BE dhe rekomandimet e Komisionit European per reduktim te asimetrise deri ne eliminim te saj ;
- Vendosja e detyrimeve per FNT te Eagle Mobile per sherbimin e terminimit te te thirrjeve ne rrjetin Eagle Mobile, eshte ne perputhje, me percaktimet e nenit 36 e ne vijim te Kreut VI te Ligjit 9918, me piken 5 te nenit 3 te Rregullores dhe me objektivat rregulatore te AKEP, te percaktuara ne nenin 7 te ligjit 9918.
- Bazuar ne arsyetimin e perdorur per ankimet e administartive te AMC dhe Vodafone, ne lidhje me terminimin e trafikut hyres nderkombetar, eshte e nevojshme qe detyrimet e Eagle Mobile te jene te njejta me ato te dy operatoreve te tjere celulare, por njekeohesisht eshte e arsyeshme qe niveli i asimtyerise te jete ai i propozuar nga Eagle Mobile pra 23%, per shkak se komercializimi i tarifes se thirrjeve hyrese nderkombetare per tre operatoret celulare krijon avantazh me te madh per dy operatoret me te medhenj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar ne piken 1 te nenit 114 dhe piken 1 te nenit 115, te ligjit nr. 9918, nenin 140 e vijues te K.Pr.A, si dhe piken 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendshme,

V E N D O S :

1. Te pranoje pjeserisht ankimin administrativ te sipermarresit Eagle Mobile sh.a., duke bere ndryshimet e meposhteme ne Vendimin nr. 1212, date 31.03.2010, te KD te AKEP:

- a. ne paragrafin "ATEHERE" te zevendesojte emrin e sipermarresit AMC sha me Eagle Mobile sh.a.
- b. pika 4.3 te ndryshojte si me poshte vijon:

4.3.1 EAGLE MOBILE sh.a per terminimin e thirrjeve ne rrjetin celular Eagle Mobile, duhet:

1. *t'u ofrojte palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij;*
2. *te ofrojte terminim te thirrjeve hyrese derkombetare ne nivel shumice, per t'u rishitur nga operatoret e autorizuar nga AKEP;*
3. *të mos anulojte aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;*
4. *të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;*
5. *të interkonektojte rrjetet ose facilitetet e rrjetit.*

Detyrimi per akses ne pikat e mesiperme i referohet vetem aksesit per mundesimin e terminimit te thirrjeve ne rrjetin celular EAGLE MOBILE, dhe jane te zbatueshme sipas mundesive/aftesive teknike dhe ekonomike te EAGLE MOBILE, si edhe me tarifa te cilat mbajne parasysh investimet e kryera dhe nje norme te arsyeshme fitimi.

- c. Pika 4.4.1 dhe 4.4.2 te ndryshohen si me poshte

4.4.1 Tarifa e terminimit te thirrjeve dhe sherbimeve te interkoneksionit te lidhura me terminimin e thirrjeve ne rrjetin Eagle Mobile jane:

- i. *Objekt kontrolli nga AKEP per terminimin e thirrjeve te origjinuara nga abonentet e rrjeteve publike telefonike ne RSH, sipas percaktimeve ne pikat 2 dhe 3 me poshte;*
- ii. *Objekt negociatash komerciale per thirrjet hyrese nderkombetare.*

4.4.2 Ne perputhje me nenin 57, pika 1 germa 'a':

- i. *Tarifa maksimale e terminimit te thirrjeve ne rrjetin Eagle Mobile, te jete te jete 12.92 lek/minute dhe tarife 0.39 lek/per thirrje.*

- d. pika 5 te ndryshojte si me poshte vijon:

“Sipërmarresi Eagle Mobile Sh.a. ka detyrimin që të zbatojë detyrime dhe specifikime të tjera të percaktuara nga AKEP, sipas nevojave të tregut, për statusin e FNT në tregun perkates të terminimit të thirrjeve në rrjetin e tij.”

2. Te gjitha percaktimet e tjera të Vendimit nr.1212 date 31.03.2010 “Për percaktimin e sipërmarresit Eagle Mobile sh.a, me Fuqi të Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese”, ngelen të pandryshuara dhe në fuqi.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**